



**ENTI RREGULLATOR I ENERGISJË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr.61, Datë 08.04.2020**

**MBI  
REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE” SH.P.K., PËR  
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGISJË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “ç”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 13, pika 2, gërma “a”, dhe pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 215, datë 20.12.2019, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, të ndryshuar me Vendimin nr. 215, datë 20.12.2019, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 08.04.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi refuzimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

**Konstatohet se:**

- Me vendimin nr. 31, datë 21.02.2020, Bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bazuar në nenin 8, 9 dhe 11 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 215/2019, pas fillimit të procedurës shoqërisë iu dërgua shkresa nr. 246/1 prot., datë 28.02.2020, për plotësimin e dokumentacionit dhe depozitimin e informacionit shtesë.
- Me shkresën nr. 62/10 prot., datë 25.02.2020, është bërë njoftimi në media, dhe pas përfundimit të afatit të pritjes se objeksioneve apo komenteve nga pale te treta ne lidhje me kete aplikim, nuk ka rezultuar të ketë pasur te tilla.
- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k, nuk ka plotësuar dokumentacionin e konstatuar të munguar.
- Aplikimi i shoqërisë “NOA Energy Trade”sh.p.k, nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:
- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”). Plotësuar pjesërisht.  
**Gërma “b“** (të dhëna identifikuese për aplikuesit).

**Gërma “c”** (të dhëna për aplikuesin). Formati i aplikimit, sipas gërmave “a”, “b” dhe “c”, të nenit 9, pika 1, të rregullores, nuk është plotësuar sipas kërkesave të Rregullores së licencimit, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 215/2019, e cila ka hyrë në fuqi më 01.01.2020.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”), Plotësuar pjesërisht.

**Gërma “d”** (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). Shoqëria nuk ka paraqitur vërtetime për gjendjen gjyqësore të personit juridik, në të gjitha selitë e rregjistruara të tij.

**Gërma “e”** (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve). Ky dokumentacion nuk është paraqitur në formën e kërkuar në nenin 8, pika 3 të rregullores.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d” ). Plotësuar pjesërisht.

**Gërma “c”** (Dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.) Shoqëria ka depozituar në ERE një vërtetim bankar, por nuk ka përcaktuar shumën që vendos në dispozicion të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

**Gërma “d”** (Vërtetim për kryerjen e pagesës së regjistrimit për aplikim). Shoqëria nuk ka kryer pagesën për aplikimin për licencim për veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike por pagesën për aplikim për rinovimin e licences.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.7 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “d”, “f”). Plotësuar pjesërisht. Nuk është depozituar në ERE në formatin e kërkuar nga neni 8, pika 3 e Rregullores.

**Gërma “e”** (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi). Shoqëria nuk ka depozituar në ERE informacion/dokumentacion nëse sistemi IT i përcaktuar prej saj është i certifikuar, nëse ka ndonjë kontratë ose marrëveshje për këtë etj.

**Gërma “g”** (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve). Shoqëria nuk ka paraqitur në ERE asnjë dokumentacion mbështetës.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

#### Vendosi :

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**